



VENDIM

Nr. 40 Datë 02.05.2012

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS OST SH.A DHE GEN – I TIRANA SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “A” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.05.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknikë të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 1510/2 Prot., datë 30.03.2012, midis OST sh.a dhe GEN – I TIRANA sh.p.k,

Konstatohet se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a dhe GEN – I TIRANA sh.p.k, janë subjekte të licensuara nga ERE respektivisht me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.03.2009, për aktivitetin e transmetimit dhe me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 129, datë 02.12.2008, për aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, te ndryshuar, si dhe me Vendimin e ERE-s nr. 146 date 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n ne cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Miratimin e marrëveshjes së Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe GEN – I TIRANA sh.p.k me ndryshimet si me poshtë:

Pikat 5.14 përpunohen si me poshtë :

Pika 5.14

Në rast kur GEN – I TIRANA sh.p.k nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo dite vonese, por jo më shumë se vlera e vetë faturës.

Pika 5.15 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI